

## **Znj. Besa Velaj**

### **Propozuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.**

Znj. Velaj ka përfunduar studimet e larta pranë Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Studimeve të Napolit “Federico II” me titullin Doktor i Shkencave Juridike. Nga viti 2021 dhe në vazhdim ushtron pozicionin si Drejtore Kabineti pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Përvoja profesionale e angazhime të ndryshme publike:

Znj. Velaj si pjesë e stafit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka mbajtur edhe rolin si Drejtuese e Projektit të Binjakëzimit IPA “Mbështetje institucionit për përafrimin e legjislacionit mbi mbrojtjen e të dhënave personale me acquis-in e Bashkimit Evropian”.

Nga viti 2017 – 2021, ka mbajtur pozicionin si Këshilltare pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Nga viti 2006 – 2016, ka mbajtur pozicionin si Senior Associate pranë zytës avokatore Boga & Associates me angazhim në fusha të ndryshme si ajo e se drejtës tregtare, gazit dhe energjisë, të drejtën e punës, financimit të projekteve (project finance), mbrojtjes së mjedisit, sigurisë së produkteve dhe atë të të dhënave. Nga vitin 2019 deri më vitin 2020, ka mbajtur pozicionin si eksperte ligjore në “Projektin e Barometrit të Reformës në Drejtësi në Shqipëri”, vënë në zbatim nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërin.

Nga vitin 2019 deri më vitin 2020, ka mbajtur pozicionin si eksperte ligjore e kontraktuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërin në kuadër të hartimit, konsultimit dhe advokimit të Udhëzimit të përbashkët të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me Këshillin e Lartë Gjyqësor mbi “Anonimizimin e të dhënave personale në vendimet gjyqësore dhe publikimin e tyre në sistemin elektronik të gjykatave”.

Nga periudha janar 2021- deri më qershor 2021, ka mbajtur pozicionin si eksperte ligjore e kontraktuar nga Transparency International Macedonia në kuadër të projektit “Përputhshmëria e legjislacionit në fushën e parandalimit të pastrimit të parave me mbrojtjen e të dhënave personale”, i mbështetur nga GIZ, si përfaqësues i Ministris Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim të Gjermanis dhe Ministrisë së Puneve të Jashtme të Norvegjis. Nga periudha tetor 2021- deri më dhjetor 2021, ka mbajtur pozicionin si eksperte ligjore (Non-Key Short Term Expert) e kontraktuar nga International Development Ireland Limited (IDI) në kuadër të projektit: “Western Balkans Proof of Concept Scheme. Nga muaji qershor 2022, Znj. Velaj është angazhuar si trajnere nga Qendra e Trajnimit të Dhomës Kombëtare të Noteris për fushën e të drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale .

Gjithashtu për periudhën 2022-2024 është angazhuar si trajnere nga Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore për fushën e të drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Znj. Velaj është Anëtare e Dhomës së Avokatisë Tiranë, është Trajnere e Çertifikuar nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike në fushën e “Zhvillimit të Planeve të Integritetit në Administratën Publike”, është Trajnere e çertifikuar nga Projekti i Binjakëzimit financiar nga programi i BE-së IPA 2017, sipas aktivitetit “Ndërtimi i institucioneve për harmonizimin me acquis të BE për të përmbushur kriteret ekonomike lidhur me mbrojtjen e të dhënave” për fushën e mbrojtjes së të dhënave personale si dhe është trajnere e çertifikuar mbi garancitë bankare

### **Ms. Besa Velaj**

**Proposed by the Commissioner for the Right to Information and Personal Data Protection.**

Mrs. Velaj has completed her higher education at the Faculty of Law at the University of Naples "Federico II," earning a Doctorate in Legal Sciences. Since 2021, she has held the position of Cabinet Director at the Commissioner for the Right to Information and the Protection of Personal Data.

#### Professional Experience and Public Engagements:

As part of the staff of the Commissioner for the Right to Information and the Protection of Personal Data, Ms. Velaj has also served as the Project Director for the IPA Twinning Project "Institutional Support for Aligning Legislation on Personal Data Protection with the EU Acquis."

From 2017 to 2021, she held the position of adviser at the Commissioner for the Right to Information and the Protection of Personal Data. From 2006 to 2016, she worked as a Senior Associate at the law firm Boga & Associates, engaging in various fields such as commercial law, gas and energy law, labor law, project finance, environmental protection, product safety, and data protection. From 2019 to 2020, she was a legal expert on the "Justice Reform Barometer Project in Albania," implemented by the Open Society Foundation for Albania.

From 2019 to 2020, she served as a contracted legal expert for the Open Society Foundation for Albania, involved in drafting, consulting, and advocating for the joint guideline of the Commissioner for the Right to Information and the Protection of Personal Data with the High Judicial Council regarding "Anonymization of personal data in judicial decisions and their publication in the electronic court system."

From January 2021 to June 2021, she was a contracted legal expert for Transparency International Macedonia as part of the project "Compliance of Legislation on Anti-Money Laundering with Personal Data Protection," supported by GIZ, representing the Federal Ministry

for Economic Cooperation and Development of Germany and the Norwegian Ministry of Foreign Affairs. From October 2021 to December 2021, she worked as a Non-Key Short Term Expert contracted by International Development Ireland Limited (IDI) for the project: "Western Balkans Proof of Concept Scheme." Since June 2022, Ms. Velaj has been engaged as a trainer by the Training Center of the National Chamber of Notaries in the field of the right to information and the protection of personal data.

Additionally, for the period 2022-2024, she has been engaged as a trainer by the Training Center of the Tax and Customs Administration in the field of the right to information and the protection of personal data.

Ms. Velaj is a member of the Tirana Bar Association, a Certified Trainer from the Albanian School of Public Administration in the field of "Development of Integrity Plans in Public Administration," and a Certified Trainer from the Twinning Project funded by the EU IPA 2017 program, focusing on "Building Institutions for Alignment with EU Acquis to Meet Economic Criteria Regarding Personal Data Protection," as well as being a certified trainer on bank guarantees.